POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 Të shtënat me armë në Tiranë, shkak u bë zhurma e djalit 3-vjeçar! Pas debatit me gruan se i shqetësonte fëmijën në gjumë, fqinji merr armën dhe i qëllon burrin (VIDEO)

2 Konfiskohet pasuria me vlerë 3 mln euro e 31-vjeçarit në Elbasan! I dënuar në Angli, Holandë dhe Shqipëri trafik droge dhe falsifikim dokumentesh

3 Në Durrës ankorohet gjigandja 'Pacific Fortitude', pritet të marrë një prej sondave gjigande të kërkimit të naftës në Shpirag

4 VKM/ Nënat e papuna që rrisin 3 ose më shumë fëmijë deri në 5 vjeç, do t'u njihen si vite pune! Ministrja: Kusht që të kenë të ardhura nën 100 mijë lekë në familje

5 Tragjedia në supermarket, futbollisti i Monza: Pata fat që nuk vdiqa, djali i vogël ishte në karrocë! Ish-mbrojtësi i Inter ndali agresorin

Kronikë

Kishin përvetësuar minierën në Krastë të Dibrës, arrestohen 2 vëllezërit! Sekuestrohen edhe 1 ton lëndë plasëse, pranga 4 të tjerëve (EMRAT)

Një operacion me emrin "Toka e artë", kanë çuar në pranga 6 persona teksa në total janë sekuestruar 1 ton e 162 kilogramë lëndë plasëse dhe 3815 kapsolla elektrike.

Redaksia
26 Tetor, 15:25 | **Përditesimi: 26 Tetor, 18:32**

Share

DIBËR- Një operacion me emrin "Toka e artë", kanë çuar në pranga 6 persona teksa në total janë sekuestruar 1 ton e 162 kilogramë lëndë plasëse dhe 3815 kapsolla elektrike.

Report Tv mëson se në pranga kanë rënë 2 vëllezërit Brolind Kotja 25 vjeç dhe Drilon Kotja 21 vjeç, të dy banues në Krastë, të cilët kishin përvetësuar dhe shfrytëzuar në mënyrë të paligjshme një minierë në Batër, Krastë. Një nga vëllezërit, më konkretisht 21 vjeçari është person me precedent të mëparshëm kriminal, i dënuar më parë për armëmbajtje pa leje. Ato u vunë në pranga pasi kishin përvetësuar një galeri në Batër dhe vazhdonin të kryenin punime, me qëllim nxjerrjen dhe shfrytëzimin e materialit minerar. Gjithashtu, është arrestuar Hajdar Bala 38 vjeç (minator/zjarrmëtar), punonjës në galerinë e përvetësuar nga dy vëllezërit. Ndaj tyre rëndon akuza për veprën penale penale "Ushtrimi i aktivitetit pa qenë i regjistruar pranë organeve tatimore", "Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyese dhe i municoneve". Gjatë kontrollit në minierën e tyre janë gjetur 20 kallëpe me lëndë plasëse dinamit (me peshë 8 kg) dhe 15 kapsolla elektrike.

LEXO EDHE:
VIDEO/ Mësuesja e gjuhës në Bulqizë godet shtazërisht nxënësin në klasë

Nga ana tjetër, po në kuadër të këtij operacioni është arrestuar edhe Ilir Lika, administrator i subjekti "Lika shpk" në Krastë dhe E. L., 33 vjeç, me detyrë minator/zjarrmëtar në këtë biznes . Lika akuzohet për Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive" dhe "Fshehja e të ardhurave", pasi në biznesnin e tij i janë gjetur 1 ton e 56 kilogramë lëndë plasëse dinamit dhe 2275 kapsolla elektrike

Gjithashtu, për të njëjtën akuzë në pranga ka rënë edhe Kujtim Lena , administrator i subjektit "Lena shpk". Dhe në biznesin e tij janë gjetur sekuestruar 96 kg lëndë plasëse dhe 1525 kapsolla elektrike. Pra në total, janë 6 të arrestuar dhe 1 ton e 162 kilogramë lëndë plasëse dhe 3815 kapsolla elektrike. Për këtë është vënë në dijeni edhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës, për heqjen e licencave të subjekteve të mësipërme.

B.K./Shqiptarja.com

TAG: Diber | lende plasese | miniera

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A e udhëheq opozitën drejt fitores koalicioni Berisha-Meta?
Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

I dënuar për trafik lëndësh plasëse, arrestohet 38-vjeçari me 2 emra në Durrës
24 Tetor, 14:20


Diga e Skavicës, qytetarët dibranë në Britani protestojnë përballë ndërtesës ku po zhvillohej panair për hidroncentralin
23 Tetor, 16:30

'Oda Dibrane' mbyll edicionin e 28-të! 14 Ansamble dhe 500 artistë në festival, Ilir Shaqiri: E bukura është që ka të rinj
17 Tetor, 19:10

Sezoni i llixhave/ Mbi 30 mijë pushues në Peshkopi: Është shumë mirë, por ka fluks! Mjeku tregon vetitë kurative
Mahir Jangulli
15 Tetor, 19:24


Tragjedia me 3 viktima në Klos, prokuroria çon për ekspertim telefonët e 2 adoleshentëve! Dyshohet se kanë fshirë mesazhet e shantazhit ndaj vajzës
Arsen Rusta
14 Tetor, 10:49

EKSKLUZIVE/ 'Goca paska qenë e dalme komplet?' Vëllai i autorit për Report Tv: Vajza shantazhohej me foto nudo nga 2 kushërinjtë! Njëri s'na e mori për nuse, na tha se 'është lidhur dhe me tjetrin'
Odeta Dume
Mahir Jangulli
13 Tetor, 11:50

Tragjedia me 3 viktima, Report Tv në Klos! Në vendin ku u vra 17-vjeçari vendosen lule! Familja Shira hap dyert e mortit! Banorët: Me fisin Mjeshtri kishin lidhje gjaku
13 Tetor, 10:37

Lirohen 2 vëllezërit e Fiqiri Mjeshtrit që vrau babë e bir në Klos! 2 kushërinjtë shantazhonin vajzën e autorit se do t'i publikonin bisedat personale në Instagram
13 Tetor, 10:05

Rruga e 'Arbrit' kthen Dibrën në atraksion turistik! Udhëtim në zemër të Korabit, majës më të lartë në Ballkan
Arbi Fortuzi
13 Tetor, 08:16


Masakër në Klos! I shantazhuan vajzën në Instagram, babai vret 17-vjeçarin dhe të atin e tij! Plagos 2 të afërmit e të miturit e më pas vret veten
12 Tetor, 14:16

Vdekja e minatorit në Bulqizë, arrestohet brigadieri dhe drejtuesi teknik i minierës
11 Tetor, 11:06

Po punonte në minierë, humb jetën minatori 52-vjeçar në Bulqizë
10 Tetor, 20:05

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje